REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**MINISTRI**

Nr. 1370/2 prot.

Tiranë, më 11/03/2020

**URDHËR**

**Nr. 156/2, datë 11.03.2020**

**PËR**

**SHPALLJEN E GJENDJES SË EPIDEMISË NGA INFEKSIONI COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21 pika 1, të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrotjen e shëndetit të popullatës dhe mospërhapjen e epidemisë nga infeksioni Covid-19,

**U R DH Ë R O J:**

1. Shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19 deri në një urdhër të dytë.

2. Instituti i shëndetit Publik dhe të gjithë institucionet e përcaktuara në ligjin 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të zbatojë protokollet specifike për ndërhyrje në situatën epidemie të shkaktuara nga COVID-19.

3. Ngarkohen Instituti i Shendetit Publk, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori Qendror i Kujdesit Shëndetësor, të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, organet e qeverisjes vendore të ndërmarin të gjitha hapat sipas planeve të veprimit në situatë epidemie.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE - TIRANË

Adresa: Rruga e Kavajës Nr 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72128 ëëë.shendetesia.gov.al